



## Shpallje

### **Për Punëtoritë e Trajnimit për studentët e fakultetit juridik dhe juristët e diplomuar të pakicës serbe dhe pakicave tjera në Kosovë për përgatitjen e provimit të Jurisprudencës, provimit të Etikës në OAK, provimin e Noterisë dhe/ose provimit për Përmbarues Privat në Kosovë**

Projekti i financuar nga BE “Mbështetja për Profesionet e Lira Ligjore dhe Shoqatën e Avokatëve” në Kosovë (Projekti) shpall **implementimin e një varg të punëtorive të trajnimit** për studentët e fakultetit juridik dhe juristët e diplomuar nga pakica serbe dhe pakicat tjera në Kosovë për përgatitjen e provimit të Jurisprudencës, provimit të Etikës në Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK), provimit të Noterisë dhe/ose provimit për Përmbarues Privat në Kosovë, me qëllim të përmirësimit të qasjes në profesionet e avokatëve, noterëve dhe përmbaruesve: profesioneve të Lira Ligjore (PLL-ve).

- **Grupet e synuara:** studentët e fakultetit juridik dhe juristët e diplomuar nga pakica serbe dhe pakicat tjera në Kosovë.
- **Objektiva: ofrimi i trajnimeve** për studentët e fakultetit juridik/juristët e diplomuar Serb të Kosovës me qëllim të **përgatitjes** së tyre për një ose më tepër nga provimet vijuese në Kosovë: i) **provimin e Jurisprudencës**, ii) **provimin e Etikës në OAK**, iii) **provimin e Noterisë dhe/ose iv) Provimin për Përmbarues Privat**.
- **Qasja Inovative:** Me qëllim të një **sinergjie më të madhe** dhe pasi që disa nga temat e trajnimeve janë të përbashkëta për disa nga provimet, trajnimet do të organizohen dhe ofrohen në një **mënyrë që i’u mundëson pjesëmarrësve** brenda mundësive që të i) **përgatiten në disa raste për lëndët për së paku dy nga provimet** për PLL-të e mësipërme, ose që të ii) **përgatiten** në rastet tjera për lëndët **vetëm për një provim të caktuar**, d.m.th. Provimin e Jurisprudencës, Provimin e Noterisë ose Provimin e Etikës.
- **Temat e trajnimeve:** temat specifike të trajnimeve përcaktohen në ligjet relevante dhe gjithashtu do t’iu dërgohen pjesëmarrësve pas pranimit të email adresave të tyre brenda afatit të mëposhtëm kohor.
- **Koha e pritur e mbajtjes së trajnimeve:** Maj 2018 – Qershor 2018.
- **Datat e Punëtorive të Trajnimit:** (disa) ditë pune brenda periudhës: 28 maj 2018 - 29 qershor 2018. Datat specifike do t’ju dërgohen pjesëmarrësve pas pranimit të email adresave të tyre.
- **Kërkesat** për kandidatët: Studentë të fakultetit juridik ose juristë të diplomuar me nënshtetësi jo shumicë.

Nga kandidatët kërkohet që t’i **dërgojnë një email** Z. Hajriz Beqiri, Menaxher i Projektit, [hajriz@klsc.eu](mailto:hajriz@klsc.eu), duke treguar interesimin e tyre për pjesëmarrje në trajnimet e lartpërmendura,

- **Afati për shprehjen e interesimit dhe konfirmimin e pjesëmarrjes:** 24 maj 2018.



An EU funded project managed by the  
European Union Office in Kosovo



**Projekti:** Objektiva e përgjithshme e projektit është fuqizimi i efikasitetit të gjyqësore përmes fuqizimit të profesioneve të lira ligjore dhe Odës së Avokatëve. Qëllimi i këtij projekti është që tërësisht ta funksionalizojë sistemin e profesioneve të lira ligjore përmes fuqizimit të Departamentit për Profesionet e Lira Ligjore dhe kapaciteteve të profesioneve të lira ligjore dhe Odës së Avokatëve. Projekti gjithashtu synon që ta përmirësojë qasjen e komuniteteve jo shumicë në Kosovë në Profesionet e Lira Ligjore.